

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

Sulmet e Metës ndaj Kim jehonë në mediet amerikane!
"Washington Post": Presidenti thotë se Amerika mund ta vrasë me raketë grupin i PD

2

Ylli Pata: Ilir Meta rihedh planin tragjik të Elbasanit për nesër!
Gati të njerë në rrugë! "Politikë Presidenciale"

3

Mungesa e vullnetit t'ua mund të bëjë që të jenë viktimë e "fretëhanave", horoskopi për ditën e sotme

4

Këtë radhë Amerika do të qendrojë këtu, nuk do të largohet si në vitin 1945

5

Mes Shqipërisë normale nga një anë dhe Ilir Metës e "Vatut" Mziut nga ana tjetër

Aktualitet

Plagosja në zyrën elektorale të PD në Kavajë, palët e përfshira rrëzojnë variantin e konfliktit politik! Rama: E qartë që s'ka motiv politik, politizimi nga PD skandaloz

Policia ka shpallur në kërkim Ndririm Jonuzi (i njohur edhe me mbiemrin Tahir) dhe dy shokët e tij Markel Shtylla e Dorian Troplini për plagosjen me armë zjarri të sekretarit të degës së PD-së në Kavajë. Edhe pse çështja u politizua shpjet nga opozita duke thënë se kjo ka ndodhur për të tensionuar fushatën elektorale, vetë Ndririm Jonuzi nga arratia ka sqaruar arsyet që sipas tij çuan në përplasje dhe se nuk ishin politike. Pas kësaj ka reaguar edhe kryeministri Edi Rama , i cili shpreh se politizimi që i bëri PD ngjarjes është skandaloz.

- Pamjet pak pas plagosjes, qytetarët ndihmojnë zyrtarin e PD-së të shkojë drejt spitalit
- Autori i plagosjes në zyrën e PD në Kavajë tregon pse ndodhi sipas tij ngjarja: I kishin bllokuar rrugën një nëne me shami
- PD i përgjigjet Ramës duke nxjerrë foton e Ndririm Jonuzit krah kryebashkiakut të Kavajës
- VIDEO/ Plagosja në zyrën elektorale të PD Kavajë, Ndririm Jonuzi priti Bashën në lokalin e tij në fushatë
- Të shtënat në zyrën elektorale të PD, Veliaj: Saliu e Iliri s'e mbajnë dot më peng Kavajën! Të dëshpëruar nga humbja

RAPORTOI Chat live me Shqiptarja.com

WhatsApp Button

Up Arrow



Lexo edhe:

Do votoj Ramën pasi nuk dua që në qeveri të kem njerëz si Xhelali


Jonuzi thotë se gjithçka ndodhi nuk ka të bëjë me politikën por për shkak se sipas tij personat me të cilët u konfliktua i kishin zënë rrugën një nënë me shami dhe pasi ky i kishte kërkuar llogari ata u sollën në mënyrë arrogante.

Të shtëna me armë në një zyrë elektorale të Partisë Demokratike në Kavajë - bënë që opozita dhe Presidentin Ilir Meta të hedhë akuza se ky është në sulm për qëllime politike. Autori Ndririm Jonuzi Tahir i shpallur në kërkim është një person me precedentë penal i dënuar në 2014 me 8 vite burg për vrasje me dashje.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 14:44

U bllogos me armë, sekretari i PD në Kavajë nxjerr bllof Metën e Bashën: Sherri nisi për parkimin e makinës, pasi u zumë fizikisht Jonuzi nxorri armën



Sekretari i Partisë Demokratike, Bledar Okshtuni i cili u plagos ditën e djeshme me armë zjarri nga Ndririm Jonuzi ka deklaruar se sherri mes tyre ka nisur për parkimin e makinës, duke nxjerrë bllof presidentin Ilir Meta dhe kreun e PD Lulzim Basha të cilët e kanë politizuar çështjen duke ia atashuar kryeministrit Edi Rama me qëllim tensionimin e fushatës. Burime bëjnë me dije për Report Tv se ai ka thënë para autoriteteve se Jonuzi e ka ofenduar, më pas fillimisht janë konfliktuar fizikisht e pastaj ai ka nxjerrë armën. Gjithë sherri sipas tij ka nisur për parkimin e makinës.



Ora 13:03

Pamjet pak pas plagosjes, qytetarët ndihmojnë zyrtarin e PD-së të shkojë drejt spitalit

Këto janë pamjet e momentit pak pas plagosjes së sekretarit të degës së PD-së në Kavajë Bledi Okshtuni. Në video shihet se si pas plagosjes kolegë të tij e mbajnë për të hipur në një makinë dhe më pas për ta dërguar në spital.




Ora 10:58

PD i përgjigjet Ramës duke nxjerrë foton e Ndririm Jonuzit krah kryebashkiakut të Kavajës

Pas deklaratës së kryeministrit Edi Rama i cili shkroi se autorët e plagosjes së aktivistit të PD në Kavajë, Bledar Okshtuni, nuk janë të Partisë Socialiste, por janë militantë të PD, ka ardhur edhe reagimi i Selinë Blu.

PD ka shpërndarë një foto ku autorët e shpallur në kërkim për ngjarjen, Ndririm Jonuzi (Tahir), Dorian Troplini dhe Markel Shtylla, janë në një tryezë, dhe sipas PD janë duke ngrënë drekë, me kryebashkiakun e PS në Kavajë, Redian krall.

"Edi Rama merret me gënjeshtria dhe manipulime ndërkohë që dhunuesit nuk janë arrestuar akoma! Asnjë gënjeshtër nuk e ndihmon dot Ramën, sepse të gjitha faktet dëshmojnë se sulmuesit e djeshëm janë njerëzit e tij dhe kanë vepruar me qëllim. Ky është një sulm kriminal kundër demokracisë sonë nga një njeri që tashmë e di se do t'i humbe zgjedhjet. Të dielën ne do të fitojmë dhe do të sjellim ndryshimin, për të cilin Shqipëria ka nevojë", thuhet në deklaratën e PD.



Ora 09:59

Plagosja e sekretarit të PD në Kavajë, Rama: E qartë që ngjarja s'ka lidhje politike! Lulzim ndahu nga Iliri e Saliu, boll bëre kukullën e të paudhëve pa din e iman


Kryeministri Edi Rama ka reaguar pas publikimit të mesazhit të autorit të plagosjes së sekretarit të PD në Kavajë, Ndririm Jonuzi Tahiri se ai nuk është socialist por me PD-në. Rama shkruan se tashmë ngjarja është e qartë që nuk është politike dhe se plagosja nuk është faj i PD, por politizimi skandaloz i kësaj çështje është faj i opozitës. Rama i bën thirrje Bashës të distancohen nga deklaratat e Ilir Metës dhe Sali Berishës, duk i quajtur si të paudhë pa din e imam.

"Është krejt e qartë që ngjarja e Kavajës s'ka asnjë motiv politik! Autori s'ka asnjë lidhje me PS, përkundrazi është militant i PD! PD s'ka faj për ngjarjen po për politizimin skandaloz! Lulëzim bëhu burrë, ndahu nga Iliri e Saliu, boll bëre kukullën e të paudhëve pa din e iman", shkruan Rama.



Ora 09:24

Autori i plagosjes në zyrën e PD në Kavajë tregon pse ndodhi sipas tij ngjarja: I kishin bllokuar rrugën një nëne me shami



Ndririm Jonuzi, i cili është shpallur në kërkim nga policia për të shtënat me armë pasditën e djeshme në një nga zyrat e Partisë Demokratike në Kavajë, nga arratia ka sqaruar arsyet që sipas tij çuan në përplasje. Jonuzi thotë se gjithçka ndodhi nuk ka të bëjë me politikën por për shkak se sipas tij personat me të cilët u konfliktua i kishin zënë rrugën një nënë me shami dhe pasi ky i kishte kërkuar llogari ata u sollën në mënyrë arrogante.



I.K./b.ha./Shqiptarja.com

T.b./b.ha./Shqiptarja.com

edi.rama tirana PD plagosje kavaje Ndririm Jonuzi Bledi Okshtuni sulmi me arme ne zyrën e PD

Markel Shtylla Dorian Troplini

Ndalohet treptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

Kush mendoni se do jetë kryeministri i Shqipërisë pas 25 prillit?

Edi Rama Lulzim Basha Nuk e di

Komento

Lajme të tjera

Aktualitet

Pipero: Pandemia drejt qytetit, në gjysmën e parë të qershorit arrijmë imunitetin e tufës! Në votime me maska dhe ruani distancën

24 Prill, 20:51

Aktualitet

Aksidenti në Vlorë, makina përplaslet me motorin! Dy persona të plagosur

24 Prill, 20:53

Aktualitet

Koronavirusi, shkon në 400 mijë numri i personave të vakcinuar

24 Prill, 20:13

Aktualitet

Pak orë nga zgjedhjet, policia e Beratit merr në mbrojtje qendrat e votimit e të numërimit

24 Prill, 20:10

Aktualitet

E diela e zgjedhjeve, moti nesër me diell e temperatura të larta

24 Prill, 19:35

Aktualitet

139 raste të reja dhe 5 humbje jete nga COVID në 24 orët e fundit

24 Prill, 18:33